



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-00013479/26 dt. 17.03.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 3-të

Koha: 17.03.2026 ora 13:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Majlinda Kurti, Igballe Islami, Valon Brahimi, Erseka Barani, Kushtrim Zeneli dhe Visar Syla

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cili theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, paragrafi 2 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë; nenit 62, paragrafi 1 dhe 2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 13, të Rregullores të Punës të Kuvendit të Komunës Nr. 12/2013, për sot kam thirrur mbledhjen e tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa (e jashtëzakonshme) me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-Rregullorja për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale
3. Propozim vendim për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026
4. Propozim-vendim për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi
5. Kërkesë për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë
6. Raport mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes pasi theksoi se në mbledhje të jashtëzakonshme nuk ka plotësim-ndryshim të rendit të ditës, e vuri në votim rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Rendi i ditës u miratua unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e dytë e KPF-së u miratua unanimisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 2

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me Draft-Rregulloren për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale, theksoi se kjo draft-rregullore ka qenë në diskutim publik, i ka kaluar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe ka ardhë në KPF për shqyrtim. Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin.

Valon Brahim: I nderuar Kryesues. Ne i kemi disa vërejtje që ndoshta në shikim të parë, mundet me u kriju përshtypja që janë gabime teknike, por ne vlerësojmë, duke u bazu në material, që është një ndryshim substancial. Drafti i parë, i cili ka kaluar në diskutim publik, te çështja e organizimit të Drejtorisë së Pronës, parashih që pika një dhe pika dy me qenë sektori për shpronësime, këmbime, shfrytëzim edhe pronë komunale, ndërkohë që, si draft i mëvonshëm, na ka ardhë që është ndryshu me sektorin e Zyrës së Strehimit dhe Pronës, domethënë që ka qenë. Po më intereson me ditë: Pse ka ndodhë ky ndryshim? Pse është deviju nga diskutimi që është mbajtur me publikun? Për arsye se në shkresën zyrtare shumë qartë, të cilën e ka përcjell Kryetari i komisionit, shkruan që palët prezente dhe as palët e treta nuk kanë pasë as komente, as sugjerime për ndryshimin e draftit të së njëjtës. Ndërkohë që neve, si draft i dytë, na është përcjellë me ndryshime, të cilat e kanë anashkalu çastin e diskutimit publik edhe kanë dalë prej procesverbalit, qysh janë dakordu komisioni në fjalë. Nuk e di tash kush mundet me dhanë përgjigje rreth kësaj çështjeje, ndoshta Drejtori i Administratës, por këto ndryshime kanë ndodhë duke iu shmangë procedurave ligjore. Në parim jemi me bashkëpunu, me ecë të gjitha pikat në Kuvend, por për syrin e një juristi është e pakalueshme mos me reagu. Nuk kemi asnjë pengesë me kalu në Kuvend kjo pikë, ta kemi të qartë, por si vërejtje është mirë mos me u përsëritë gjëra të tilla. Shumë, shumë miqësisht po kërkoj me u përmirësu, me u kompletu. Me ju përshtatë procedurave që janë në Rregulloren për hartimin e akteve komunale, janë procedura që nuk kalohen, nuk mund me u deviju çështja që është diskutu në një diskutim publik, ku ka pasë pjesëmarrës edhe, kur Komisioni e konstaton saktë që s'ka pasë kërkesa, sugjerime dhe është dakordu me shku më tutje. Unë e kuptoj që ka të drejtë ekzekutivi me organizu qysh dëshiron punën e vet, edhe ne jemi pro, bashkëpunojmë, ndihmojmë aq sa kemi mundësi. Nuk jemi pengesë për me shku në Kuvend, të jemi të qartë, vetëm me u plotësu më mirë. Faleminderit!

Igballe Islami: Është e qartë që komisioni, në raportin e tij, thotë se me e-mail nuk kanë ardhur kërkesat për plotësim-ndryshim e as në takimin që është mbajtur me anëtarët e komisionit, e as me pjesëmarrësit në takim. Mirëpo, edhe një pikë tjetër që nuk ka qenë e përfshirë as gjatë konsultimit publik, neni 10, e që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, është Lista e klasifikimit të pozitave në shërbimin civil të Komunës së Mitrovicës së Jugut, nuk ka qenë pjesë përbërëse as gjatë diskutimit publik e as tash nuk na ka ardhë me material në KPF, nëse kjo nuk bashkangjitet nuk dihet çfarë pozitash do të ketë dhe kush do të jetë stafi i kësaj drejtorie të re, pra gjithçka është e paqartë. Edhe shtimi i një sektori ndikon drejtpërdrejt në organizimin e Komunës së Mitrovicës dhe që do të ketë ndikim edhe në organogramin e Komunës. Kështu që pjesë përbërëse e rregullores duhet të jetë Lista e klasifikimit të pozitave për shërbimin civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Mungon përgjigja e Zyrës së burimeve njerëzore, të cilëve u është kërkuar një koment lidhur me këtë rregullore, ndërsa sa i përket përgjigjes së Zyrtarit kryesor financiar për ndikimet financiare buxhetore, përgjigja është e qartë se cilat janë mundësitë reale për ndryshim eventual në strukturën organizative.

Nazmi Jashari: Sa i përket shqyrtimit publik, kjo rregullore është vendosur në diskutim publik më datë 27 shkurt. Në këtë fazë janë paraparë si diskutimet publike ashtu edhe konsultimet. Diskutimi publik është organizuar më 27 shkurt dhe ka vazhduar deri më datë 7 mars. Gjatë kësaj periudhe, ku kam qenë edhe unë pjesëmarrës, nuk janë paraqitur vërejtje apo kërkesa me përmbajtje substanciale, vërejtjet e mundshme kanë qenë më tepër të natyrës formale. Megjithatë, gjatë fazës së konsultimit, e cila ka zgjatur deri më datë 6, ka ekzistuar mundësia që edhe ekzekutivi të propozojë ndryshime në Rregullore. Pra, duke pasur parasysh që diskutimi publik ka përfunduar më datë 7 mars, këtë informacion desha vetëm t'juaj përcjell për sqarim.

Igballe Islami: E kam përcjellë me vëmendje krejt procesin lidhur me këtë draft-rregullore, nuk është ndërruar vetëm një sektor, këtu janë ndërruar edhe detyrat dhe përgjegjësitë, me shumë seriozitet e kam shqyrtuar këtë draft-rregullore, nuk jam për me e penguar, sepse është e drejtë e ekzekutivit me e organizuar Komunën e mënyrën qysh juve ju përshtatet. Në raportin e Komisionit që e kemi marrë me material, ku përmendet ecuria e krejt procesit, Kryetari i Komisionit ka thënë se nuk ka marrë asnjë vërejtje, as në e-mail zyrtar, deri në fund të procesit, pra deri më datën 6 mars, ndër të tjera thuhet se drafti po përcillet pa ndryshime nga ne. Pra ajo që ne po kërkojmë është të na vijë për shqyrtim drafti i cili ka qenë në konsultim publik dhe të njëjtit t'i bashkangjitet Lista e klasifikimit të pozitave për shërbimin civil në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Valon Brahim: Qëllimi është i mirë, të përmirësohen gjërat që duhet të përmirësohen, roli ynë si KPF është që t'ia lehtësojmë punën Kuvendit. Pavarësisht bindjeve politike, ne jemi njerëz, nuk jemi që ta pengojmë por dokumenti të procedohet konform ligjit.

Kryesuesi Safet Kamberi: Dikush nga ekzekutivi duhet të jap sqarim, të na e shpjegojë ecurinë e këtij procesi që nga fillimi dhe ta merr përgjegjësinë që vërejtjet e KPF-së me ja përcjellë propozuesit në mënyrë që ky draft të ecë tutje për Kuvend.

Nazmi Kelmendi (Drejtor i DGJKP-së): Nuk kam qenë pjesë e Komisionit që e ka hartuar këtë draft-rregullore, por po jap një sqarim si Drejtor i DGJKP-së. Agjensioni Kadastral i Kosovës shumë shpejtë në kuadër të vet ka me e fut shërbimin gjeodezik dhe kadastral, për shkak të shërbimeve digjitale që i jep, ky është informacion zyrtar të cilin e kam unë, e pashë të rrugës ta jap këtë sqarim, kështu që Drejtoria e Pronës duhet me u formuar me patjetër prej pushteteve lokale, pastaj mënyra e organizimit, organogrami e buxheti janë çështje tjera për të cilat unë nuk mund të flas, kjo është procedurë që duhet me u vazhdu.

Gazmend Gjosha (Drejtor i DBF-së): Përhëndetje për të gjithë, unë e kam propozuar që Sektori i pronës, i cili është në kuadër të Drejtorisë së Financave, të kalojë në Drejtori të Pronës, besoj që është në të mirë të të gjithë qytetarëve dhe do të thjeshtësohen shumë gjëra.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Draft-Rregulloren për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale.

Rezultati i votimit: 4-për, 0-kundër, 1-abstenim.

Draft-Rregullorja për plotësim të Rregullores Nr. 01/2022 Për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës Komunale u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me Propozim vendimin për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026, për ta arsyetuar të njëjtin ljalën ia kaloi Drejtorit të DGJKP-së z. Nazmi Kelmendi.

Nazmi Kelmendi: Propozim-vendimin meqë e keni marrë me kohë, po dua me ju njoftu shumë shkurt, për shkak që jam duke e pritur gjendjen juridike të parcelave kadastale, mundet me pasur ndryshime. Jam duke e pritë një e-mail zyrtar prej Avokatit të Komunës, prej Drejtorisë së Financave, prandaj propozim vendimi mundet me e pasë ndonjë ndryshim, prandaj po ju kërkoj mirëkuptim, sepse nuk po varet gjithçka nga unë. Në asamble vjen ky propozim vendim, por me disa ndryshime.

Igballe Islami: Drejtor, unë i kam vërejtjet e mia sa i përket kësaj pike. E the, drejtor, që edhe vetë je i sigurt që kjo pikë nuk është në rregull, nuk e ke konfirmimin e Zyrës Ligjore dhe, meqenëse ti edhe nuk je i sigurt për pronësinë, ose jo të atyre pronave, nëse janë pronësi të komunës, pse na e ke sjellë në Komitetin për Politikë dhe Financa? Edhe pse jemi plotësisht në dijeni që afati për dhënien e këtyre pronave në shfrytëzim është deri më 31 mars, krejt kjo është bërë si një lehtësim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit për ju si qeverisje e re, mirëpo unë me të vërtetë jam shumë e shqetësuar qysh nuk keni arritur ende me kompletu këtë pikë dhe me iu drejtuar Komitetit për Politikë dhe Financa ashtu siç duhet. Ne sot e dimë që kjo mbledhje e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa, përveç tjerash, është thirrur me ju mundësuar edhe kësaj pike me vazhdu tutje dhe me procedu në Kuvend brenda afatit ligjor, mirëpo unë i kam dyshimet e mia dhe besoj që edhe anëtarët tjerë, edhe pse janë të pozitës, nuk kisha dashur me i pa duke e votu dikush këtë pikë. Unë e kam marrë me vete edhe dokumentin se si është procedu kjo pikë e rendit të ditës gjatë mandatit të kaluar qeverisës. Nuk ka të bëjë me procedurat, kjo ka të bëjë me gjithçka që është ligjore. Drejtor, ju i keni vendos vetëm vendndodhjen, numrin e parcelës dhe kohën për sa keni me e dhënë, po ju nuk keni dokumente nga Drejtoria e Urbanizimit ku e specifikon destinimin e pronës. Unë para vetes nuk e kam destinimin e pronës, unë nuk e kam certifikatën e pronësisë, unë nuk e kam kopjen e planit dhe nuk i kam ortofotot, prandaj një dokument të tillë shumë më mirë është mos me e procedu për Kuvend, të hiqet nga rendi i ditës. Tjetra, nuk e keni konfirmimin e Zyrës Ligjore sa i përket kësaj pike. Me këtë dokument nuk e di a jemi duke i aprovu parcelat të cilat janë pronësi ose jo të komunës. Pa dokumentet, certifikatën e pronësisë, pa destinimin e pronës, e cila është ekskluzivitet i Drejtorisë së Urbanizimit, pa ortofotot, pa kopje të planit, kjo pikë nuk është e kompletuar për me vazhdu tutje as në Komitet e as në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, kështu që unë votoj kundër kësaj pike.

Nazmi Kelmendi: Certifikatat e pronësisë i kam me vete, nuk ua kam bashkangjitur me material.

Valon Brahim: Procedimi i këtij materiali nuk ka të bëjë me çështje teknike, mungojnë dokumentet bazë, propozim-vendimi në Kuvend të vije i kompletuar ashtu siç parashihet me ligj, t'i bashkangjiten certifikatat e pronës, destinimi, kopja e planit, ortofotot, lista si e tillë nuk e përmbush asnjë kriter për procedim tutje.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026; me sugjerimet e anëtarëve të KPF-së që këtij propozim vendimi t'i bashkangjitet: destinimi i pronës sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës, certifikata e pronës dhe ortofotot.

Rezultati i votimit: 4 për, 2 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026 u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim vendimin për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi.

Igballe Islami: Faleminderit shumë për trajtimin e kësaj kërkesë, rastin e dimë të gjithë, është rast shumë i ndjeshëm, kërkoj nga Drejtoria e Shëndetësisë që nëse ekziston mundësia që vlera e shumës të jetë 10,000.00 €.

Albina Kastrati Rama (Drejtoreshë e Shëndetësisë): Kërkesa për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi ka qenë 5,000.00 €, ne e kemi proceduar propozim vendimin me shumën prej 6,000.00 €, pra është rritur shuma për 1,000.00 €, më vije keq po nuk kemi mundësi ta rrisim këtë vlerë më shumë.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim vendimin për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi.

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim vendimi për lejimin e mjeteve financiare për trajtim mjekësor jashtë vendit për znj. Elijona Brahimi u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 5

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me Kërkesën për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtorit të DMS-së z. Ramadan Beshiri.

Ramadan Beshiri (Drejtor i DMS-së): Përshëndetje për të gjithë. Normalisht, ne si Drejtori i Mirëqenies, me marrjen e mandatit të ri të qeverisjes lokale dhe të drejtorisë, kemi hasur në disa probleme dhe mangësi që kanë mbetur si pasojë e skadimit të kontratës më 14.10.2025. Për këtë arsye, e kemi parë të arsyeshme që, përveç vazhdimit të kontratës, të propozojmë edhe arsyetimin e një kohëzgjatjeje trevjeçare. Duke u bazuar në kornizën ligjore, që buron nga Rregullorja Komunale nr. 08/2023 për subvencionet, kërkoj që kontrata të vazhdohet për një periudhë trevjeçare. Kjo do të mundësonte që të përballohet rritja e fuqisë punëtore çdo vit, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një marrëveshje që përfshin dy segmente, përkatësisht dy zona, ku në dy prej tyre është rritur çmimi për 60 euro, ndërsa në një zonë tjetër për 80 euro. Në këtë mënyrë, do të mund të ruajmë parancë publike, duke vazhduar me një kontratë apo marrëveshje trevjeçare, si dhe të shmangim problemet që zakonisht paraqiten me skadimin vjetor të kontratave.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Igballe Islami: Parimisht, kjo mangësi ka ndodhur për shkak se Kuvendi nuk ka qenë funksional, ndërsa që nga janari e tutje, përgjegjësi bie mbi ju, pasi nuk e keni proceduar më tej këtë çështje. Në parim, ne e mbështesim këtë iniciativë dhe, natyrisht, përkrahim idenë e subvencionimit, pasi është një praktikë që ka vite që zbatohet dhe paraqet një përfitim të rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Mitrovicës. Megjithatë, kërkoj që kësaj kërkesë t'i bashkëngjitet një konfirmim ligjor mbi disponueshmërinë financiare të mjeteve, duke pasur parasysh se jemi duke hyrë në obligime kontraktuale trevjeçare. Po ashtu, kërkoj të paraqitet një vlerësim i qartë ligjor nëse kjo është në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në mënyrë që kontratat të jenë plotësisht në harmoni me kornizën ligjore dhe rregulloren në fuqi. Kjo kërkesë mbështetet edhe në konfirmimin e Zyrës Ligjore, të cilin e keni pranuar më 4 mars, ku është theksuar se neni përkatës nuk ka nevojë për sqarime shtesë dhe se neni 40 i Rregullores Komunale për subvencionim e përcakton qartë se bëhet fjalë për "banorët rezidentë të Komunës së Mitrovicës së Jugut". Megjithatë, duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe

Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të cilat mund të paraqesin kufizime, vlerësoj se ekziston paqartësi lidhur me ligjshmërinë e kësaj kontrate. Duke marrë parasysh edhe ndjeshmërinë e temës, theksoj se kjo çështje nuk duhet të politizohet, pasi bëhet fjalë për shpenzimet e varrimit – një fushë ku nuk duhet të ketë vend për politikë. Prandaj, për Kuvendin, duke qenë se e-maili zyrtar i Zyrës Ligjore ngre dyshime mbi ligjshmërinë e plotë të kësaj kontrate, kërkoj që të silltet një konfirmim i qartë ligjor lidhur me pjesën veriore, duke specifikuar nëse është në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Gjithashtu, konsideroj se një konfirmim financiar do të ishte i nevojshëm dhe i dobishëm, duke qenë se po hyjmë në obligime kontraktuale për një periudhë trevjeçare.

Ramadan Beshiri: Faleminderit shumë për të gjitha sugjerimet. Po filloj nga fundi, u diskutua për marrëveshjen, e cila ka të bëjë me komunat veriore. Kjo është marrëveshje që ka qenë edhe më e hershme. Kjo është një marrëveshje ekzistuese, e datës 30.10.2024, Kryetari Bedri Hamza ka bërë vetëm vazhdimin e saj. Duke u bazuar në këtë marrëveshje, kërkohet që të ofrohet shërbimi i varrimit në territorin e Komunës së Mitrovicës edhe për banorët e fshatrave Çabër, Kelmend, Boletin, Zhazhë, Bistricë, Cerajë dhe Koshtovë. Sa i përket çështjes së pagesave për shpenzimet e varrimit, theksoj se nuk është e mundur të përcaktohet një kosto e saktë, pasi nuk mund të parashikohet numri i rasteve (vdekjeve). Këto hyjnë në kategorinë e shpenzimeve të paparashikueshme, siç përcaktohen në fushën e ekonomisë dhe financave. Në lidhje me kornizën ligjore, pajtohem me shqetësimet e ngritura dhe konfirmoj se do të kërkojmë sqarime shtesë. Me rastin e shqyrtimit në Kuvend, do të sjell informata të detajuara për të dëshmuar se propozimi është i bazuar në kornizën ligjore në fuqi. Sa i përket mendimit të Zyrës Ligjore, ata kanë qenë në dijeni që propozimi parasheh një periudhë trevjeçare, mirëpo nuk e kanë nënshkruar formularin. Megjithatë, në interpretimin e tyre kanë theksuar se çështja është e rregulluar në mënyrë specifike. Përfundimisht, lidhur me kornizën ligjore, do të vij me sqarime shtesë në mbledhjen e Kuvendit.

Valon Brahim: Faleminderit, drejtor, për sqarimet. Vlerësoj se, nëse kjo pikë është miratuar gjatë qeverisjes së kaluar, atëherë ka qenë një veprim i gabuar dhe nuk është dashur të procedohet në atë formë. Për këtë, përgjegjësinë e bartin ish-anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa që e kanë lejuar një gjë të tillë. Ne kemi vetëm qëllim të mirë në këtë rast. Megjithatë, ekziston rreziku që kjo marrëveshje, në momentin kur dërgohet në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për konfirmim të ligjshmërisë, të kthehet me vlerësim negativ. Prandaj, konsideroj se është më e arsyeshme gjetja e një zgjidhjeje të mirë, përfshirë edhe tërheqjen e pikës përkatëse, në mënyrë që të mos rrezikohet ofrimi i këtyre shërbimeve për qytetarët e tjerë. Në të kundërtën, do të ishte e nevojshme një listë e gjerë e ndryshimeve në aktet juridike përkatëse, në mënyrë që kjo marrëveshje të mund të kalojë. E kuptoj qëllimin e mirë dhe theksoj se ofrimi i këtij shërbimi është i domosdoshëm.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Kërkesën për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë.

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kërkesa për vazhdimin e marrëveshjes me Këshillin e Bashkësisë Islame në Mitrovicë u miratua unanimisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 6

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi para se të hapë diskutimin lidhur me Raportin mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026, për ta arsyetuar të njëjtin fjalën ia kaloi Drejtores së DSE-së znj. Fitore Behrami.

Pas arsyetimit të Raportit nga ana e Drejtores së DSE-së znj. Fitore Behrami, Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin.

Valon Brahim: Faleminderit, drejtoreshë! Edhe për këtë raport kemi vërejtjet tona. Vlerësojmë se raporti është i mangët. Nuk është i shoqëruar me metodologji që tregon se si është bërë vlerësimi, kush e ka realizuar atë, dhe mungojnë fotografitë përcjellëse që do të dëshmonin dëmet e shkaktuara në objekte të caktuara. Sa i përket çështjes së ekonomive familjare dhe bujqësisë, kam vërejtje të arsyeshme. E njoh situatën faktike dhe e di që disa prej ngjarjeve të përfshira në raport nuk kanë ndodhur, megjithatë nuk do të ndalem te kjo pjesë. Ajo që më intereson është çështja e bizneseve. Kërkoj sqarim nëse është e vërtetë që janë shmangur formularët e vlerësimit në këtë proces. Gjithashtu, do ta kërkoj në Kuvend, nëse e lejon rregullativa ligjore, që të kemi edhe një organ vëzhgues (jo mbikëqyrës), i cili do të shoqërojë komisionin në terren për të verifikuar dëmet e raportuara. Kërkoj që fotografitë për secilin rast të na paraqiten në seancën e ardhshme. Po ashtu, kam një vërejtje konkrete: në raport figuron se kompensimi më i madh, në vlerë prej 65,000 €, i është ndarë një biznesi pa adresë. Konkretisht, bëhet fjalë për Gazmend Pccin – Mitrovicë. Të gjitha bizneset e tjera kanë adresat e tyre, prandaj kërkoj të di pse ky biznes nuk ka adresë të evidentuar, duke qenë se e dimë që ARBK nuk regjistron asnjë biznes pa adresë dhe pa numër në Urbanizëm. Do të ishte mirë që këto sqarime të jepen në seancën e radhës. Në parim jam për ta kaluar raportin, por nëse këto vërejtje nuk adresohen, do t'i paraqes përsëri në seancën e ardhshme. Qëllimi nuk është të pengohet procesi, por ky raport ka mangësi dhe është i pamjaftueshëm. Po flasim për para publike dhe për një çështje që bart përgjegjësi politike, morale dhe ligjore. Specifikisht kërkoj që për bizneset të na paraqitet dokumentacioni i plotë: fotografi për secilin rast, mënyra se si është bërë vlerësimi dhe kush e ka realizuar atë. Ka edhe raste kur anëtarë të komisionit kanë bërë vetëvlerësim, gjë që përbën konflikt interesi. Për pjesë të tjera nuk do të ndalem, por kërkoj qartësi të plotë sa i përket bizneseve. Faleminderit shumë!

Fitore Behrami: Faleminderit Valon, për mbledhjen e radhës së Kuvendit Raporti mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës do t'iu vijë i plotësuar me foto dhe adresat e bizneseve përfituese.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026 (të plotësuar sipas vërejtjeve të anëtarëve të KPF-së).

Rezultati i votimit: 6 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Raporti mbi vlerësimin e dëmeve si pasojë e vërshimeve në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, janar 2026 (i plotësuar sipas vërejtjeve të anëtarëve të KPF-së) u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 14:00 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI

Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI